



**Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri**

**Fjalim i Ambasadorit Osmo Lipponen, Kryetari i Prezencës
Konferencë Shtypi, 4 shkurt 2003**

Mirëmëngjes zonja dhe zotërinj të shtypit,

Këtë të enjte, unë do të paraqes një raport mbi aktivitetet e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, të zhvilluara që nga koha që mora detyrën e re në tetor të vitit të kaluar, para Këshillit të Përhershëm me 55 anëtarë të OSBE-së në Vienë. Unë do të mbuloj katër muajt e fundit, që kur mbërrita këtu, të cilat kanë qenë një kohë ndryshimesh në Prezencë. Vëmendja më e madhe është përqëndruar në ristrukturimin e brendshëm të Prezencës, në caktimin e aktiviteteve prioritare dhe kanalizimin e punës së saj, në mënyrë që ajo të përqëndrohet më mirë në ato çështje që janë themelore për zhvillimin e mëtejshëm institucional të Shqipërisë. Unë po pres me padurim të mësoj komentet dhe udhëzimet e Këshillit të Përhershëm për punën tonë aktuale.

Këto përpjekje kanë sjellë atë që unë do ta quaja përmirësim i cilësishëm i marrëdhënieve të Prezencës me qeverinë dhe institucione të tjera. Me hapjen zyrtare të negociatave për Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asociim me Bashkimin Evropian të premtën e kaluar, Shqipëria hyri në një fazë tjetër të zhvillimit të saj. Ky është një tregues që flet për evolucionin e punës së Prezencës në vend.

Ulja e tensioneve politike gjate gjashte muajve te fundit, qe nga zgjedhja e Presidentit Alfred Moisiu, kontribuoi ne arritjen e ketij perparimi duke zgjidhur disa ceshtje te vjetra te shumediskutuara. Ajo beri te mundur zgjidhjen e ceshtjeve delikate si reforma zgjedhore dhe pronesia permes dialogut dhe kompromisit. Kjo fryme e nje debati politik me te normalizuar duhet te vazhdoje, ne menyre qe zgjedhjet lokale, te parashikuara per me vonë gjatë këtij viti, të mund të zhvillohen mbi bazën e shëndoshë të konkurrencës së shëndetshme, dhe jo të konfliktit.

Brenda këtij kuadri, unë jam i kënaqur të vërej se fillimi i politikës bazuar në debatin e çështjeve konkrete është i dallueshëm. Ajo që u vu re më shumë ishte se debati publik në fund të vitit për shkak të shqyrtimit nga parlamenti të buxhetit të shtetit për 2003-shin shtroi për diskutim çështje interesante lidhur me përparësitë e qeverisë, programet e saj dhe mënyrën e financimit të tyre. Pjesëmarrja aktive e opozitës në këtë proces zbuloi përfitimet potenciale për vendin nga normalizimi i marrëdhënieve politike. Në këtë aspekt, Prezenca ka punuar për forcimin e rolit themelor të parlamentit si kontrollues i qeverisë.

Megjithë përmirësimet në sferën politike, ka ende disa çështje thelbësore që kanë nevojë të zgjidhen, për të cilat nevojitet roli i Prezencës dhe aftësia e saj për të nxitur komunikimin e ndihmuar në arritjen e kompromisit.

Prezenca vazhdon të japë ndihmesën e saj në punën e Komisionit Parlamentar Dypalësh për Zbatimin e Rekomandimeve të ODIHR-it dhe ka mbështetur sigurimin e asistencës teknike të

ODIHR-it lidhur me çështjet kryesore zgjedhore. Komisioni ka funksionuar mirë si një mekanizëm për gjetjen e konsensusit, duke u marrë me çështje shumë të diskutuara, ndërsa ndodhet tani përballë sfidës së hartimit të projektamendamenteve të Kodit Zgjedhor. Vështirësitë e kohëve të fundit kanë nxjerrë në pah nevojën për angazhimin e vazhdueshëm të palëve për të mos lejuar platformat politike të ngadalësojnë apo bllokojnë përparimin në hartimin e legjislacionit. Unë do të shkoj me bashkëkryetarët e komisionit në Vienë, ku ata do të kenë mundësinë të informojnë delegacionet e OSBE-së lidhur me përparimin e arritur dhe planin e punës për të ardhmen.

Lidhur me çështjen e pronave, Prezenca e ka studiuar këtë gjë për një kohë të gjatë dhe është angazhuar me liderët politikë për të ndërmjetësuar një dialog përfshirës. Ndërsa 50% e proceve gjyqësore kanë në qendër të tyre konflikte për shkak të pronësisë, është e rëndësishme që kjo çështje e vjetër të trajtohet përmes përcaktimit analitik të problemeve të legjislacionit ekzistues dhe të situatës së tanishme në terren, në mënyrë që të arrihet një zgjidhje krejtësisht e zbatueshme dhe e mbështetur në konsensus.

Ka disa fusha specifike të reformës institucionale që mund të forcohen përmes përpjekjeve të Prezencës, në bashkëpunim me partnerët e saj ndërkombëtarë, për të siguruar vendosjen e shtetit të së drejtës, ruajtjen e sigurisë, veçanërisht, përballë sfidave në rajon të krimit të organizuar dhe kërcënimeve jotradicionale. Me qëllim nxitjen e këtyre politikave, natyra e punës së Prezencës është orientuar më shumë nga projektet për ta çuar më tej zhvillimin institucional të Shqipërisë përmes aktiviteteve më konkrete.

Për shembull, në vitin 2003, Prezenca do të përqëndrohet në sigurimin e mbështetjes për Prokurorinë e Përgjithshme dhe për zhvillimin e një gjyqi të drejtë në sistemin gjyqësor. Ajo do të vazhdojë, gjithashtu, të punojë për të ngritur një mekanizëm të mbrojtjes së dëshmitarëve, deri në krijimin e një kuadri legjislativ. Për të çuar më tej procesin demokratik përmes reformës zgjedhore dhe mbështetjes për parlamentin, Prezenca po zbaton një projekt shumë të suksesshëm për Edukimin me të Drejtat e Grave dhe Luftën kundër Trafikut, një rrjet i Qendrave të Zhvillimit të Shoqërisë Civile, si dhe po siguron asistencë të specializuar për Këshillin Kombëtar për Radio dhe Televizionin për të zhvilluar një plan praktik të frekuencave për vendin, në përputhje me standartet evropiane.

Gjatë gjashtë muajve të ardhshëm, aktiviteti politik dhe projektet e asistencës së Prezencës do të përqendrohen të mbështesin edhe më tej zhvillimin e institucioneve demokratike. Përveç kësaj, projektet e Prezencës brenda departamentit të shtetit të së drejtës/të drejtat e njeriut dhe atij të bashkëpunimit për sigurim do të mbështesin forcimin e institucioneve gjyqësore të Shqipërisë dhe luftën e tyre kundër korrupsionit e krimit të organizuar ndërkufitar.